



Informata për prindërit

Mësimdhënia dhe vlerësimi i bazuar në Planprogramin Mësimor të Kantonit të Glarusit për Shkollën Fillore

Prindër të nderuar

Planprogrami mësimor i Kantonit të Glarusit e përshkruan mënyrën se si fëmija Juaj mund të mësojë dhe aftësohet. Duke u bazuar në këtë, bëhet edhe vlerësimi i fëmijës Tuaj në përgjithësi. Që të mësuarit të është i suksesshëm për fëmijën Tuaj, vlerësimi i orientuar në promovim/nxitje luan rol qëndror.

Mësuesit orientim të punës e kanë planprogramin mësimor. Planifikimi i mëimit është i mbështetur në të.

Mësuesit i verifikojnë rregullisht të arriturat mësimore të nxënësve. Bazë e verifikimeve janë objektivat mësimore në mësim. Nxënësit janë të njohur me kërkesat e objektivave mësimore. Arritja e qëllimeve mësimore verifikohet në mënyra të ndryshme:

- Vëzhgimet gjatë orës mësimore
- Të folurit, mendimet e nxënësve
- Të dhënat nga projektet dhe punimet shkollore
- Arritjet mësimore në klasë si dhe në provime

Të gjitha arritjet në të mësuar mësuesit i përmbledhin dhe i vendosin me shkrim në librezë.

Vlerësimi shërben për të nxitur dhe mbështetur të mësuarit e nxënësve.

Të vlerësuarit e gjithëanshëm

Shkolla mundëson të mësuarit e gjithëanshëm. Nxënësit mësojnë në lëndë të ndryshme (gjuhë, matematikë, muzikë dhe aftësi tjera profesionale dhe ndërdisiplinore pavarësi, bashkëpunimi në grup dhe tjera).

Gjatë orës mësimore bëhet nxitja e zhvillimit të aftësive të shumta. Për këtë duhen detyra të veçanta.

Detyrat e mira janë:

- sfiduese
- të përshtatura me njohuritë
- të përshtatura aftësisë
- mbështetëse në pavarësi
- mbështetëse në të mësuar
- mbështetëse gjatë punës.

« Vlerësimi i gjithëanshëm përqëndrohet në suksesin e të mësuarit »

Vlerësimi është...

... i përshtatur në të mësuarit

Çdo vlerësim rrjedh nga situatat e të mësuarit në orë mësimore.

...promovues dhe nxitës

Vlerësimet dhe reagimet e nxisin të mësuarit dhe zhvillimin e fëmijës Tuaj dhe tregojnë hapat tjerë mësimorë.

... transparent

Në mbledhjen vjetore të prindërve Ju do të informoheni lidhur me arritjet dhe zhvillimin mësimor të fëmijës Tuaj.

... i plotë

Shkathësitë teknike dhe ndërdisiplinore do të përfshihen në vlerësim.

Mbledhja vjetore e prindërve

Në mes Ju si Prindër, fëmijës Tuaj dhe mësuesve, mbahet çdo vit një mbledhje. Në këtë mbledhje të gjitha vëzhgimet dhe vlerësimet do të i shpalosni së bashku. Ju, mësuesit dhe fëmija Juaj do të bisedoni për nivelin e zhvillimit dhe të mësuarit. Për këtë nevojitet një parapregatitje e mirë. Ju keni mundësinë të i paraqitni shqetësimet dhe mendimet Tuaja. Fëmijën Tuaj e ndihmojnë mësuesit që të parapregatitjet.

Zakonisht, fëmijët e kalojnë shkollimin pa masa specifike apo vendime lidhur me të ardhmën e tyre shkollore. Por, nëse është nevoja për masa, ato do të shqyrtohen në mbledhjen vjetore të prindërve dhe analog do të bëhet kërkesa për miratim tek Udhëheqësija e Shkollës.

Masa janë si për shembull:

- Mbështetje nga pedagogët shërues të shkollës
- Gjermanishtë sie gjuhë e dytë amtare (DaZ)
- Logopedi (terapi e të folurit)
- Psikomotorikë (terapi në lëvizje, ndjenja, sjellje)
- Përshtatje e planprogramit mësimor aftësive të fëmijës apo dispenzim

Vendime për të ardhmen shkollore janë:

- Caktimi në një klasë hyrëse ose të vogël
- Përsëritja e një klase
- Kapërcimi i një klase
- Ndryshimi i nivelit në klasat e mesme I

Dëftesat dhe librezat e suksesit

Libreza e suksesit e përshkruan gjithanshëm suksesin e fëmijës Tuaj si dhe tregon që mbledhja vjetore e prindërve është mbajtur.

Në parashkollore dhe në klasën e parë nuk ka nota në librezë. Korrespondon me një vërtetim të shkollës. Nga klasa e dytë e shkollës fillore fillon vlerësimi i lëndëve me nota.

Në klasat e larta I (Sekundarstufe I) nxënësit notohen për çdo gjysmëvjetor shkollor.

Nga klasa e pestë fillore në librezë do të vlerësohen edhe aspekte të aftësive ndërdisiplinore. Ato janë sjelljet ndaj punës, të mësuarit dhe sjelljet në shoqëri.

Gjatë një viti shkollor ka shumë raste ku nxënësi vlerësohet apo nuk vlerësohet. Një pjesë të këtyre informatave fëmija Juaj i sjell në shtëpi apo edhe ju tregon për to.

Për të dhënë notën në librezë, mësuesit i shfrytëzojnë të gjitha informatat dhe i peshojnë dhe i krahasojnë ato.

Kjo do të thotë, që nota nuk është llogaritje aritmetike e notave gjatë vitit shkollor. Nota tregon një vlerësim të gjithëanshëm, pra sukcesi i nxënësve që e tregojnë me shkrim, me gojë dhe në praktikë për secilën lëndë mësimore.